



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2026

Lënda: Matematikë

Udhëzime për nxënësin:

Testi ka **25 pyetje**.

Testi në total vlerësohet me **50 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Në pyetjet me alternativa qarkoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigje së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikë								
Pyetja	9	10	11	12	13	14a	14b	15a
Pikë								
Pyetja	15b	16	17	18a	18b	19a	19b	20
Pikë								
Pyetja	21	22a	22b	23	24	25a	25b	25c
Pikë								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Jepen bashkësitë $A = \{1, 2, 3, 4, 5, 6\}$ dhe $B = \{3, 4, 5, 7\}$.

Bashkësia $A \cap B$ është:

1 pikë

- A) $\{1, 2, 3, 4, 5, 6, 7\}$
B) $\{3, 4, 5\}$
C) $\{2, 3, 4\}$
D) $\{1, 2, 3\}$

2. Rezultati i pjesëtimit $\frac{6}{5} \div \frac{3}{10}$ është:

1 pikë

- A) 1
B) 2
C) 3
D) 4

3. Nëse Rea pagoi 288 lekë për 2,4 kg domate, sa lekë kushtonte 1 kg domate?

1 pikë

- A) 160 lekë
B) 130 lekë
C) 140 lekë
D) 120 lekë

4. Një gazetar deklaroi se kompania A jep për bamirësi $\frac{7}{25}$ e fitimit vjetor.

Sa përqind të fitimit përbën kjo shumë?

1 pikë

- A) 28%
B) 26%
C) 24%
D) 22%

5. Shprehja $(-2x)^3$ është e njëvlershme me:

1 pikë

- A) $8x^3$
B) $6x^3$
C) $-6x^3$
D) $-8x^3$

6. Një lulishte ka formën e një sektori qarkor me kënd qendror 60° dhe rreze 12 m. Sa metra është perimetri i kësaj lulishteje?

1 pikë

- A) $4(\pi + 6)$
B) $6(\pi + 6)$
C) $8(\pi + 6)$
D) $10(\pi + 6)$



7. Trajta e zbërthyer e shprehjes $(x+2)(x-1)$ është:

1 pikë

- A) $x^2 - 2x - 1$
B) $x^2 + x - 1$
C) $x^2 + x - 2$
D) $x^2 - x + 2$

8. Cila nga figurat e mëposhtme ka **vetëm një** bosht simetrie?

1 pikë

- A) 
- B) 
- C) 
- D) 

9. Vlera e funksionit $f : y = 1 - 2x$ për $x = -2$ është:

1 pikë

- A) 5
B) 4
C) -3
D) -5


10. Një nga zgjidhjet e inekuacionit $x + \frac{1}{2} \leq 1$ është:

1 pikë

- A) 0
B) 1
C) 2
D) 3

11. Bazuar te të dhënat e trekëndëshit në skicë, cila nga shprehjet e mëposhtme shpreh perimetrin e tij? 1 pikë

- A) $2x + 2y + 3$
B) $2x + 2y + 2$
C) $x + y + 3$
D) $x + y + 2$




12. Katërkëndëshi ABCD në skicën e mëposhtme është një paralelogram.

Bazuar te të dhënat e kësaj skice, sa është vlera e x -it?

1 pikë

- A) 60°
B) 80°
C) 100°
D) 120°




13. Mbi brinjët e trekëndëshit kënddrejtë ABC janë ndërtuar tre katrorë si në figurë.

Syprinat e tyre janë përkatësisht S_1 , S_2 dhe S_3 .

Qarkoni pohimin i cili është gjithmonë i vërtetë për këtë situatë.

1 pikë

- A) $S_3 > S_1$ dhe $S_2 > S_1$
B) $S_1 + S_2 = S_3$
C) $S_1 - S_2 = S_3$
D) $S_1 = S_2$



Pyetjet 14-25 janë me zhvillim dhe arsyetim.

14. Në planin koordinativ paraqitet trekëndëshi A.


- a) Shkruani koordinatat e kulmit të këtij trekëndëshi, i cili ndodhet më larg origjinës së koordinatave.

1 pikë

Përgjigje: (____ ; ____)

- b) Vizatoni shëmbëllimin e trekëndëshit A në simetrinë sipas boshtit Ox.

1 pikë



15.

- a) Zbërtheni në prodhim faktorësh të thjeshtë numrat e mëposhtëm:

2 pikë

$$36 =$$

$$24 =$$

- b) Gjeni pjesëtuesin më të madh të përbashkët të numrave të dhënë, $PMP(36; 24)$.
Tregoni veprimtarinë tuaj.

2 pikë

16. Provoni duke kryer veprimet se vlera e thjeshtuar e shprehjes $\frac{3\sqrt{2} + 2\sqrt{8}}{\sqrt{98}}$ është 1.

3 pikë

17. Në një avion 44% e pasagjerëve janë meshkuj.

Numri i femrave në këtë avion është 140.

Sa pasagjerë ka gjithsej në avion? Mbështesni përgjigjen tuaj përmes veprimeve matematikore.

2 pikë

18. Më poshtë përshkruhet veprimtaria e dy nxënësve në kryerjen e një detyre.

- a) Nxënësi A do të vizatojë një model të Kullës “The Eye - Full” të Londrës, e cila është 120 m e lartë. Nëse shkalla e përdorur është 1:2500. Sa e lartë do të jetë kjo kullë në model?

2 pikë



- b) Nxënësi B ka vizatuar modelin e “The London Ear” (rrota e famshme, një pikë referimi e famshme në Londër), e lartë 80 m. Lartësia e rrotës në model është 16 cm. Sa është shkalla e modelit? Përgjigjja të jepet në formë të thjeshtuar.


2 pikë

19. Më poshtë është paraqitur hapja e një kubi me brinjë a cm .

Nëse gjatësia e segmentit $AC = 2\sqrt{5}$ cm , gjeni:

- a) vlerën e a -së.

2 pikë




- b) syprinën anësore të këtij kubi.

2 pikë

20. Jepet rrethi me diametër segmentin AB dhe qendër në pikën O. Dihet se $AC = OA$.

Gjeni duke arsyetuar $m(\hat{BAC})$.

2 pikë



21. Zgjidhni me metodën tuaj më të përshtatshme sistemin e ekuacioneve.

3 pikë

$$\begin{cases} x + 2y = 5 \\ x - y = 2 \end{cases}$$

22. Një varg numerik e ka kufizën e parë 1.

Rregulla e kufizës pasardhëse është “**shto tre**”.

a) Shkruani dy kufizat e tjera pas kufizës së parë të kësaj varge.

1 pikë

b) Shkruani formulën e kufizës së përgjithshme a_n .

2 pikë

23. Drejtëza (a) e ka koeficientin këndor 2 dhe pret boshtin e ordinatave në pikën $(0; 5)$.

Shkruani ekuacionin e drejtëzës (a).

2 pikë

24. Aliza përzieu acid dhe ujë në raportin $3,5 : 4,5$ dhe përftoi 320 ml tretësirë.

Sa acid dhe sa ujë ka kjo përzierje?

3 pikë

25. Tabela e dendurive tregon kohëzgjatjen t në minuta të bisedave telefonike në një qendër kujdesi për klientët.

Kohëzgjatja e telefonatës, t (minuta)	Denduria
$0 < t \leq 7$	5
$7 < t \leq 14$	18
$14 < t \leq 21$	10
$21 < t \leq 28$	7
$28 < t \leq 35$	4
$35 < t \leq 42$	6

a) Cila është klasa modale?

1 pikë

b) Në cilën klasë ndodhet mesorja? Tregoni arsyetimin tuaj.

2 pikë

c) Sa përqind e bisedave kanë zgjatur më shumë se 28 minuta?

2 pikë